



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri  
Mbledhja nr. 35  
Prishtinë, më 6 nëntor 2009  
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225  
Mbledhja filloi në orën 11: 00

**P R O C E S V E R B A L**

**I mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri**

**Morën pjesë:** Rustem Mustafa, Shkumbin Demaliaj, Eqrem Kryeziu, Lulzim Zeneli dhe Zylfi Merxha.

**Munguan:** Melihate Tërmkollli, Bojan Stojanović, Suzana Novobërdaliu dhe Zafir Berisha.

**Nga Zyra Mbështetëse morën pjesë:** Nur Çeku, Antigona Ibraj, Nuredin Ibishi dhe Blerina Pula.

**Mbledhjen e kryesoi:** Rustem Mustafa, kryetar i Komisionit.

**Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të datës **09. 10. 2009**
3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale
4. Të ndryshme

*Kryetari - Në hapje të mbledhjes i dëshiroi mirëseardhje anëtarit të ri të Komisionit, Lulzim Zenelit. Pasi konstatoi se ishin plotësuar kushtet, e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës*

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të datës 09. 10. 2009**

*Procesverbali i datës 09. 10. 2009 u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për mbrojtjen e të dhënave personale**

**Kryetari i Komisionit** – Tha se është bërë praktikë të thuhet se ky ligj është i rëndësishëm, por unë mendoj se të gjitha ligjet që miratohen në Kuvend janë të rëndësishme. Ju e dini si e kemi praktikën e deritanishme në Komision: ta caktojmë një referues që punon bashkë me grupin e punës për shqyrtimin e ligjit, pastaj raportin me rekomandime e sjellë që ta shqyrtojmë në Komision. Unë kam menduar për këtë ligj ta caktojmë referuese Melihate Tërmkollin, mirëpo ajo sot nuk është këtu e pranishme dhe nuk e di si të procedoj më tutje. Nëse dikush ka ndonjë propozim le të urdhërojë.

**Eqrem Kryeziu** – Ne, edhe në mungesë, mund ta caktojmë referuese Melihate Tërmkollin dhe në qoftë se ajo e refuzon, atëherë secili prej nesh mund të bëhet referues për këtë ligj.

**Kryetari** – Edhe unë besoj se Melihate Tërmkollin nuk do ta refuzojë të jetë referuese për këtë ligj, por sido që të jetë ne po vendosim këtu për Melihate Tërmkollin. Nëse ajo do ta refuzojë, atëherë do ta caktojmë dikë tjetër referues.

*Anëtarët e Komisionit u pajtuan që Melihate Tërmkollin të jetë referuese për Projektligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.*

### **5. Të ndryshme**

**Kryetari** – Në këtë pikë dua t'ju njoftoj se na ka ardhur Strategjia për Siguri Kombëtare. Ju e dini se unë përfaqësoj në Këshillin për Siguri Kombëtare. Ju, si anëtarë të Komisionit, mund të vini në zyrën time ta shikoni këtë draft edhe pse nuk është publik. Por mendoj se nuk kemi arsye as ta fshehim, as ta bëjmë publik. Pra ta dini se çdo punë që vjen tek unë vjen edhe për anëtarët e Komisionit. Prandaj ju them se ju mund të vini ta shihni draftin dhe të sugjeroni se çka dëshirojmë të shtojmë në atë draft.

Ju e dini se tani janë formuar edhe dy komisione të reja, Komisioni për FSK-në dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Iteligjencës. Ne, si Komision, tani i kemi më të qarta punët tona, se nga duhet të orientohemi më shumë dhe besoj se kemi mjaft punë për të bërë.

**Eqrem Kryeziu** - Unë e kisha ngritur një çështje, nëse kjo bie në kompetencën e Komisionit tonë. Pra kisha kërkuar që policia e Kosovës të mos involvohet në fushatën zgjedhore. E kam fjalën jo si fansa, sepse kishte vërejtje. Nuk është mirë që policët të kenë fanatizëm partiak. Kjo s'është e mirë, besoj, për asnjë parti politike.

**Shkumbin Demaliaj** - Unë pajtohem me këtë shqetësim, sepse ne si AAK kemi pasur pengesa në Klinë, ku ndërhyri Policia e Kosovës me radiolidhjet e tyre edhe gjatë kohës së mbajtjes së fjalimit të fushatës. Prandaj ju lus që, si kryetar i Komisionit, të bëni thirrje në media që Policia e Kosovës të ketë kujdes në këto raste.

Pasi nuk kishte pika të tjera për të diskutuar, kryetari i Komisionit e mbylli këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 12: 10

E hartoi:

Njësia Mbështetëse e Komisionit

Kryetar i Komisionit

-----  
Rrustem Mustafa